

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9374, DATË 21.4.2005, “PËR NDIHMËN SHITETËRORE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”, është mbështetur në nenet 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në kuadër të luftës pa kompromis kundër krimit të organizuar, ky projektligj është hartuar me qëllim e vetëm për të mos lejuar përfitimin, mbështetjen dhe lehtësitë e parashikuara nga ligji, jo vetëm nga subjektet përfitues të ndihmës, të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale, të cituara në pikën 1, të nenit 4/1, të këtij projektligji, por edhe në rastet kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës apo ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda subjektit përfitues të ndihmës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve, por miratimi i tij vjen si një domosdoshmëri për trajtimin e fenomeneve shumë problematike të hasura në praktikë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në bazë të legjislacionit në fuqi, çdo subjektet përfitues i ndihmës, në kuptim të këtij ligji, që kërkon të fitojë ndihmën shtetërore, duke përfituar mbështetje dhe lehtësi, duhet të plotësojë, paraprakisht, disa kushte, të cilat ndahen në kushte ligjore, ekonomiko-financiare dhe teknike.

Kjo nismë ligjore u ndërmor duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë e qeverisë për të luftuar kriminalitetin në vend, duke shmangur në çdo rast dhe me çdo mjet dhënien e mbështetjes dhe krijimin e lehtësirave për subjektet përfituese të ndihmës shtetërore të dënuar penalisht,

Një parashikim i tillë, ku përjashtohet nga mundësia e dhënies së mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave jo vetëm subjektit përfitues të ndihmës, që ka një dënim penal si subjekt juridik, por edhe kur individët përfaqësues të subjektit kanë një dënim të tillë, do të shmangë çdo mundësi që subjektet dhe këta individë të dënuar penalisht të fitojnë mbështetje dhe lehtësira, në kuptim të këtij ligji.

Ky rregullim i posaçëm do ta bëjë jo vetëm më serioze, por edhe më konkrete luftën me të gjitha mënyrat kundër krimit në Shqipëri.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”, propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj propozon që pas nenit 4 të shtohet neni 4/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Përjashtimi nga përfitimi i ndihmës shtetërore

1. Përjashtohet nga përfitimi i ndihmës shtetërore, kur ka të dhëna se subjekti përfitues i ndihmës, në kuptim të këtij ligji, është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:
 - a) Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;
 - b) Korrupsion;
 - c) Mashtrim;
 - ç) Pastrim parash ose financim i terrorizmit;
 - d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, ose nxitje, ose ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste;

- dh) Organizimi, drejtimi ose financimi i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
- e) Falsifikim;
- ë) Puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

2. Përfshirja nga përfitimi i ndihmës shtetërore zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i subjektit përfitues të ndihmës, në kuptim të këtij ligji, aksionar ose ortak i tij apo ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij.
3. Me qëllim plotësimin e kushteve për të përfituar ndihmën shtetërore, subjekti përfitues i ndihmës duhet të paraqesë vërtetim nga dosja gjyqësore ose një dokument të lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë, në Kryeministri.

Projektligji është bashkërenduar me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE